



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.665/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rrustem Thaqi, kryesues, Faton Ademi dhe Ferki Xhaferi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesë e parashtruar nga Gordanski Iniciativa Zubin Potok, paraqitur kundër anëtareve të KVV, në Zubin Potok për shkak të parregullsive gjatë procesit të numërimit të votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të datës 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 20.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

Hudhet e pa parregullt ankesa Anr.665/2021, e datës 18.10.2021, e paraqitur nga Gordanski Iniciativa Zubin Potok, kundër anëtareve të KVV në Zubin Potok, për shkak të parregullsive në procesin e votimit dhe të numërimit të votave, në Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të datës 17 tetor 2021.

A r s y e t i m

Më datën 18.10.2021 PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.665/2021, të ushtruar nga Gordanski Iniciativa Zubin Potok, me të cilën pretendon se gjatë procesit të votimit disa votues kanë votuar disa herë, po ashtu theksohet se për një veprim të tillë Kryetari i i KKZ-së u informua për këtë gojarisht por nuk pati efekt, na thanë se kishim prishur ditën e zgjedhjeve sepse po pengonin parregullsi si dhe përfaqësuesi i yni ishte tërë kohën nën presion që veprime të tilla të mos i raportonte, po ashtu gjatë procesit të numërimit të votave në vendvotimin 2802-01B na janë anuluar 20 vota për këshilltar. Pas rinumërimit në vend të 10, numri i votave ishte 33 që dëshmon përpjekje të dukshme për të na e zvogëluar numrin e votave.

Paneli, pasi që vlerësoj lejueshmërinë e ankesës të lartpërmendur, gjeti se:

Ankesa është e parregullt,

Paneli, nga shkresat e lëndës vlerësoj se ankesa e paraqitur nga Gordanski Iniciativa Zubin Potok, kundër anëtarëve të KVV në Zubin Potok janë të parregullta, pasi që ankesa e paraqitur në PZAP, nuk është e nënshkruar nga ankuesi, andaj ankesa e paraqitur nuk i plotëson kushtet ashtu siç parashihet me nenin 5.6 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, ku theksohet se *“ankesat duhet të dorëzohen me shkrim dhe të jenë të nënshkruara nga ankuesi apo në emër të tij nga i autorizuari. Në rastet kur ankuesi/ja është parti politike, koalicion, iniciativë qytetare apo nga çfarëdo personi tjetër juridik, ankesa duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi i autorizuar i atij personi juridik siç është përcaktuar në rastet ku kjo është e mundshme në çfarëdo dispozite ligjore në fuqi”*.

Prandaj Paneli, me rastin e shqyrtimit të lejueshmërisë së ankesave, gjeti se e njëjta është e parregullt sepse nuk është nënshkruar nga ankuesi, dhe se e njëjta nuk i plotëson kriteret sipas nenit 5.6 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, andaj nuk u lëshua fare në meritat e ankesës, ngase nuk janë plotësuar kushtet e kërkuara nga dispozita e lartcekur.

Nga arsyet e lartcekura e në mbështetje të nenit 5.6 të Rregullës Nr.02/2015 për Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, dhe në kuptim të dispozitës së nenit 118.1 të LZP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.665/2021 më datën 20.10.2021



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.